



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 25 mars 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Şinik, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arsim Bajrami dhe Ardian Gjini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Artan Canhasi – EULEX, Lejla Selimi – OSBE, Visar Smajlaj - ekspert, Blerta Bejtullahu – EUSR/EU, Rebeka Maliqi dhe Burbuqe Berisha – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.03.2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-176 për turizmin;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në pikën të ndryshme të futen edhe:

- Projektligji për Agjencinë për krahasimi dhe verifikim të pronës;

- Projekt-rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Projektligji për ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.3.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit Funkcional, në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, në mënyrë unanime nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin Nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-176 për turizmin;

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit Funkcional, në Projektligjin për turizmin dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Përfundim

1. Projektligjin Nr. 04/L-176 për turizmin dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;

2. Projektligji me amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme

a. Projektligji për Agjencinë për krahasimi dhe verifikim të pronës

Kryetari – Tha se ky Projektligj është në kundërshtim me Kushtetutën, edhe pse ne i kemi rekomanduar seancës që mos ta miratojë. Këtë Projektligj seanca e miratoi në parim. Si Komision, duhet që të merremi në mënyrë më specifike sa i përket këtij Projektligji dhe të shohim se çka do të bëjmë, sepse kemi dhënë rekomandimin negativ.

Armend Zemaj – Tha se ky Projektligji është në kundërshtim me Ligjin bazik dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në pikat e caktuara që edhe e ka verifikuar Komisioni. Tashmë kemi vendimin e Kuvendit, i cili e ka miratuar këtë Projektligj dhe nuk është çështje e Komisionit. Nëse ka ndonjë iniciativë tjetër nga ana e deputetëve për delegimin e kësaj çështje në Gjykatën Kushtetuese, si një instancë e cila e interpreton ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë atëherë, kjo është një çështje tjetër. Ne nuk kemi çka të debatohet sot në Komision lidhur me këtë çështje, sepse vendimin e ka marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ky projektligj kaloi me votimin e deputetëve. Tha se sa i përket pjesës ku kemi konstatuar shkeljen të formohet një grup punues për plotësimet dhe ndryshimet që mund t'i bëjnë në këtë Projektligj, eliminimin e defekteve të neneve që janë në kundërshtim me ligjin për përfundimin mbikëqyrurës ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Halit Krasniqi – Ai tha se kjo çështje është trajtuar mjaft seriozisht dhe se nuk kemi çfarë të shtojmë, por kemi një vendim dhe qëndrim të Kuvendit. Këtij Komisioni i mbetet të formojë një grup punues dhe t'i shprehë qëndrimet e veta me ballafaqimin që kemi me Kuvendin në takimin e radhës.

Albulena Haxhiu – Tha se është shqetësuese si Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton projektligje të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto projektligje nuk duhet të shqyrtohen në Kuvend, por duhet t'i kthehen propozuesi në këtë rast siç është Qeveria. Ky projektligj është diskutuar katër herë në Komision dhe nuk kemi mundur që të gjejmë zgjidhje, madje as edhe përfaqësuesit e Qeverisë që ishin të pranishëm në Komision nuk na ofruan as një arsyetim lidhur me Projektligjin për Agjencinë për krahasim dhe verifikim të pronës. Sa i përket këtij Projektligji tha se nuk sanksionohet krimi, por vetëm sa formatizohet. Kuvendi vendosi themelimin e një agjencie, i cila kontrollohet nga përfaqësuesi special. Prandaj jemi kundër këtij Projektligji dhe mendoj se Komisioni duhet ta trajtojë shumë më seriozisht këtë çështje, në mënyrë që mos të lejojë këtë Projektligj të kalojë edhe në shqyrtim të dytë. Komisioni nuk duhet të formojë grupe punuese, por duhet t'ia kthejë Qeverisë.

Haki Demolli – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve tha se të gjithë anëtarët e Komisionit kemi diskutuar shumë gjatë për këtë çështje, se ky Projektligj është në kundërshtim

me Kushtetutën dhe me ligjin për përfundimin e mbikëqyrurës ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. E vlerësoi të pa kuptimtë faktin që Kuvendi e miratoi në parim këtë Projektligj për kundër faktit që Komisioni kishte rekomanduar mos miratimin e tij, sepse kjo detyrë neve na është besuar nga ana e Kuvendit. Ishte i mendimit se duhet të formohet një grup punues dhe dispozitat të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën të përmirësohen dhe në leximin e dytë projektligji mos ta ketë përmbajtjen e njëjtë.

Kryetari – Tha se sa i përket këtij Projektligji në ditën e parë në seancën plenare ka ndodhur një lëvizje politike e qëllimshme, humbja e kuorumit, sepse kishin frikë se nuk do të kalonte ky Projektligj. Në seancën e dytë Kryetari i Kuvendit përdori rregulloren e punës së Kuvendit për kalimin e këtij. Ai tha se nuk do jem pjesë e grupit punues. Jam kundër këtij Projektligji, sepse është në kundërshtim me ligjin për përfundimin e mbikëqyrurës ndërkombëtare të pavarësisë. Nëse propozimet e parapara në këtë ligj mbesin siç janë dhe kalohen në seancën plenare, atëherë do të shohim se çka do të bëhet. Mendoj se përgjegjësinë për amendamentimin e këtij Projektligji duhet ta marrë shumica parlamentare dhe kërkoj që Behar Selimi të jetë kryesuesi i grupit punues.

Albulena Haxhiu – Në fjalën e saj të serishme tha se nuk ka logjikë që Komisioni të formojë grupin punues. Sigurisht që ky Projektligj do të kalojë, sepse pozita do të kujdeset për votat e mjaftueshme në Kuvend. Ne do të shkojmë edhe në instancat e tjera, në Gjykatën Kushtetuese, sepse ky Projektligj nuk ka bazë ligjore. Pyetja se nga e merr përgjegjësinë përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për të qenë fuqi ekzekutive në Kosovë ? Qeveria po tenton që marrëveshjet me Serbinë, negociatat e ashtuquajtura teknike, t'i miratojë përmes ligjeve, kur dihet që marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me 2/3. Është e pa precedent që një shtet të mos ketë regjistrin e evolucionit të transaksioneve pronësore, pra kopjet nga Serbia. Nuk do të jem pjesë e grupit punues, por do ta kundërshtoj edhe në Seancën Plenare këtë Projektligj, sepse është kriminal.

Kryetari – Tha se ne, si Komision, kemi dy rrugë që mund t'i ndjekim, njëra rrugë është që Komisioni të qëndrojë prapa rekomandimit që e kemi dhënë, ose ta amendantojmë Projektligjin. Në këtë rast kuptohet se duhet të ndryshohet i tërë Projektligji, sepse ndryshohet komplet bordi i agjencisë, sekretaria dhe përbërja e saj dhe në fund të fundit mund të ekzistoj Agjencia Kosovare e Pronës. Ideja ka qenë që Agjencia Kosovare e Pronës duhet të shuhet në këtë vit, sepse ka përfunduar punën dhe të shndërrohet në Agjencinë për verifikim dhe krahasim të pronës. Propozuesi duhet ta arsyetojë në Kuvend se si e ka bërë një gjë të tillë dhe më befason fakti se si deputetet e votuan këtë Projektligj.

Behar Selimi – Tha se lidhur me këtë Projektligj ka pasur kundërshtime të vazhdueshme nga ana e opozitës edhe në seancën plenare, por ne, si Komision, kemi pasur një qëndrim që ka kundërshtime me dispozitat kushtetuese dhe cenohet ligji për përfundimin e mbikëqyrurës ndërkombëtare të pavarësisë. Mirëpo, tash jemi në një situatë ku ekziston një vullnet politik i Kuvendit me të cilin vullnet edhe është aprovuar ky Projektligj. Ne mund ta ruajmë dinjitetin e Komisionit ta presim afatin e propozimit të ndryshimeve dhe kur vjen afati i përmbylljes së punë tonë këtë projekt t'ia përcjellim Kuvendit atëherë ne e mbajmë edhe një takim me të cilin ne deklarohemi si Komision, a jemi për apo kundër dhe i drejtohem Kuvendit që është organi më i lartë. Nëse ne duhet të formojmë grup punues atëherë më mirë do të ishte që ta drejtojë opozita,

sepse ata janë kundër dhe ne ua mundësojmë që t'i bëjnë ndryshimet, ose në të kundërtën të dalim nga kjo situatë e marrim një grup dhe bëjmë përpjekje t'i bëjmë ndryshimet aq sa edhe mundemi. Ne, duhet t'i dimë mundësit tona dhe kufizimet që i kemi në këtë proces, atëherë kemi dy zgjedhje, ose e lëmë kështu siç është, ose presim amendamentet për t'i mbetet besnik i shqetësimeve dhe kundërshtimeve, por shqetësohem se do humbim kohë dhe nuk do të ndryshojmë asgjë, sepse këtu ndryshimi duhet të jetë esencial, ose të kthehet komplet Projektligji.

Armend Zemaj – Në fjalën e tij të serishme tha se ka pasur debate të mjaftueshme në Komision dhe seancën Plenare për këtë Projektligj dhe Qeveria nuk e ka pasur vullnetin për tërheqjen e këtij Projektligji dhe u miratua me shumicën e votave të deputetëve. Ne jemi në një fazë të caktuar që në afatin kohor ta përcjellim për leximin e dytë. Qeveria e ka mundësinë që ta tërheqë deri në lexim të dytë në çdo kohë. Ne, si opozitë, duhet maksimalisht t'i bëjmë ndryshimet për heqjen e elementeve që janë në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Atëherë shohim nëse prapë shumica e deputetëve votojnë amendamentet kundër kushtetuese. Ne, si opozitë, dhe ata nga pozita që kanë pasur mendimin e njëjtë, sa i përket këtij Projektligj të angazhohemi. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri publikisht është deklaruar që të gjitha konkluzionet ja kam dorëzuar Kryetarit të Kuvendit. Kryetari, jo rrallë herë ka thënë se unë nuk jam i njoftuar për marrëveshjet. Do të ishte mirë që këto marrëveshje t'i dorëzohen Komisionit për Legjislacion.

Kryetari propozoi që kjo pikë të diskutohet në një mbledhje të radhës, si pikë e rregullt e rendit të ditës dhe pastaj Komision të marrë vendim.

Komisioni për Legjislacion e përkrahi propozimin që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në një mbledhje të radhës.

b. Projekt-rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Armend Zemaj – Komisioni e ka përfunduar punën qysh vitin e kaluar dhe rregullorja është në Kryesinë e Kuvendit dhe kjo varet se kur kryesia do ta procedojë në seancën plenare.

Albulena Haxhiu – Sa i përket rregullores së Kuvendit tha se ka dy vite që ka përfunduar dhe prapë po sillet nëpër Kuvend, nuk di se kush po e pengon miratimin e saj në seancën plenare. Sa i përket rregullores për ne, si subjekt politik është mjaft e rëndësishme që të kalojë, sepse është paksa më e avancuar se rregullorja aktuale dhe kërkoi që të miratohet sa më parë.

c. Projektligji për ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Kryetari kërkoi sqarime nga Kryesuesi i Grupit punues në Projektligjin për ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke shtuar se ka vonesa rreth shqyrtimit dhe amendamentimit për kundër faktit që ekspertet e angazhuar nga Komisioni i kanë sjellë ekspertizat në Komision.

Armend Zemaj – E njoftoi Komisionin me punën e grupit punues në Projektligjin për ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Tha se e kemi parë të arsyeshme që ta bëjmë një vizitë në njërin nga institucionet korrektuese, por deputetet nuk ju kanë përgjigjur ftesës për realizimin e kësaj vizite. Andaj unë, si kryetar i grupit punues, nuk e pashë të arsyeshëm shkuarjen i vetëm në këtë vizitë. Në takimin e radhës i kemi të gjitha amendamentet e kompletuara, por ishim të interesuar që praktikisht të shohim disa ndryshime që janë bërë, se si funksionojnë ato në praktikë. Sa i përket afatit kohor, ne jemi në afat, por e kemi një propozim shtesë që është bërë nga Gjykata e apelit dhe Këshilli gjyqësor që kanë ardhur me vonesë, por janë të arsyeshme që ne të merremi me trajtimin e tyre, në mënyrë që projektligji të jetë funksional dhe i aplikueshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi